



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°10/2022

Hagë, 17/03/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, ZPS-ja dhe dy ekipet e Mbrojtjes përfunduan deklaratat përmbyllëse dhe iu përgjigjën pyetjeve të gjykatësve. Të akuzuarit kanë të drejtën të flasin të fundit dhe deklaratat e tyre pritet të dëgjohen sot.

Trupi Gjykses rifilloi procesin gjyqësor me qëllim pranimin e disa deklaratave të caktuara të dorëzuara nga Mbrojtja. Këto deklarata janë disa dëshmi dëshmitarësh që Trupi Gjykses vendosi t'i pranojë me qëllimin e vetëm të përcaktimit të dënimit, në rast se Trupi Gjykses do të vendosë për shpallje të fajësisë lidhur me ndonjë nga akuzat e paraqitura në Aktakuzë.

Paneli i Gjykatës Kushtetuese ka marrë në shqyrtim tri kërkesa referuese të dorëzuara përkatësisht nga z. Thaçi, z. Krasniqi dhe z. Veseli. Ditën e martë Paneli udhëzoi ZPS-në të dorëzojë parashtrimet e veta brenda 29 marsit, nëse dëshiron, për t'iu përgjigjur pyetjeve konkrete të ngritura prej Panelit si dhe tre parashtruesit të dorëzojnë përgjigjet e tyre brenda 5 prillit, nëse dëshirojnë.

Më 24 mars, në orën 14:30 është planifikuar seanca tjetër e procedurës paraprake në çështjen kundër z. Thaçi dhe të bashkakuarve.

Në çështjen *Salih Mustafa*, më 21 mars është planifikuar seanca tjetër në të cilën ka pranuar të marrë pjesë një nga viktimat për të shprehur mendimet dhe shqetësimet e veta para Trupit Gjykses. Seanca do të fillojë në orën 9:30.

1





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°10/2022

Hagë, 17/03/2022

Gjithashtu, në çështjen *Mustafa*, më 22 mars Mbrojtja do të fillojë paraqitjen e provave me deklaratat hyrëse dhe më 23 mars pritet të fillojë dhënien e dëshmisë dëshmitari i parë.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

